

V E N D I M
Nr. 298, datë 27.6.2002

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.194, DATË 22.4.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGËS TË PUNONJËSVE
MËSIMORË NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR", ME NDRYSHIMET PËRKATËSE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 e 6 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat në caktimin e pagave të punës", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.194, datë 22.4.1999 të Këshillit të Ministrave, me ndryshimet përkatëse, të bëhen këto ndryshime:

1. Lidhja nr.1 "Struktura e pagës për punonjësit mësimorë", lidhja nr.2 dhe lidhja nr.3, "Shpërblimi mujor për punonjësit mësimorë në arsimin parauniversitar, që punojnë larg vendbanimit" zëvendësohen me lidhjet me të njëjtin numër, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2002 për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 16 korrik 2002.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

LIDHJA NR.1

Emërtimi	Paga mujore				
	Paga individuale			Shtesa e profesionit	
	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Totali
Drejtor i shkollës së mesme Përgjegjës poligoni Dr.Inst.Nxën.që nuk shikojnë Dr.Inst.Nxën.që nuk dëgjojnë Dr.në shkolla me PLM Drejtor i konvikteve	1	2% e PG për çdo vit pune	5% e PG 10% e PG 20% e PG	13 350	NgaLekë Deri.....Lekë
Zv/Dr në shkollë të mesme Zv/Dr.në inst.e nx. që nuk shikojnë e dëgjojnë dhe shkollat me PLM Dr.i Qendrës Kult. të fëmijëve Përgjegjës i bazës prodhuese	1	2% e PG për çdo vit pune	5% e PG 10% e PG 20% e PG	11 130	NgaLekë Deri.....Lekë
Dr.i shkollës 8-vjeçare	1	2% e PG për çdo vit pune	5% e PG 10% e PG 20% e PG	10 800	NgaLekë Deri.....Lekë
Dr.i shkollës fillore (klasa I-IV) Përgjegjës (kryemësuesi)i shk.me klasë kolektive Zv/Dr.i shkollës 8-vjeçare Përgjegjës sektori në Qendr.Kult. të fëmijëve	1	2% e PG për çdo vit pune	5% e PG 10% e PG 20% e PG	9 350	NgaLekë Deri.....Lekë
Dr.i kopshtit me ushqim	1	2% e PG për çdo vit pune	5% e PG 10% e PG 20% e PG	8 000	NgaLekë Deri.....Lekë
Dr.i kopshtit pa ushqim	1	2% e PG për çdo vit pune	5% e PG 10% e PG 20% e PG	6 600	NgaLekë Deri.....Lekë

Mësues në shkollat e mesme Mësues në Inst.e nx.që nuk shikojnë e nuk dëgjojnë dhe në shkollat me PLM	1	2% e PG për çdo vit pune	5% e PG 10% e PG 20% e PG	9 450	NgaLekë Deri.....Lekë
Mësues në shkollat 8-vjeçare (I-VIII) Edukator konvikti Kujdestar konvikti Instruktur Qendr.Kulturore të Fëmijëve	1	2% e PG për çdo vit pune	5% e PG 10% e PG 20% e PG	7 600	NgaLekë Deri.....Lekë
Edukator në kopësht fëmijësh	1	2% e PG për çdo vit pune	5% e PG 10% e PG 20% e PG	5 600	NgaLekë Deri.....Lekë
Mësues	2	2% e PG për çdo vit pune	5% e PG 10% e PG 20% e PG	7 300	NgaLekë Deri.....Lekë
Mësues	3	2% e PG për çdo vit pune	5% e PG 10% e PG 20% e PG	7 300	NgaLekë Deri.....Lekë
Edukator në kopësht fëmijësh	3	2% e PG për çdo vit pune	5% e PG 10% e PG 20% e PG	6 030	NgaLekë Deri.....Lekë
Edukator në kopësht fëmijësh	2	2% e PG për çdo vit pune	5% e PG 10% e PG 20% e PG	6 030	NgaLekë Deri.....Lekë

LIDHJA NR.2

Grupi	Paga në lekë
1	8 100
2	6 415
3	5 800
4	3 850

LIDHJA NR.3

SHPËRBLIMI MUJOR PËR PUNONJËSIT MËSIMORË NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR QË PUNOJNË LARG VENDBANIMIT

Mësuesit që punojnë larg vendbanimit të tyre marrin shpërblim si vijon:

- Kur punojnë brenda rrethit të tyre, por larg vendbanimit dhe kthehen brenda ditës në vendbanimin e tyre, deri në 1 200 (njëmijë e dyqind) lekë, kur nuk kthehen brenda ditës në vendbanimin e tyre deri në 3 500 (tre mijë e pesëqind) lekë.

- Kur punojnë jashtë rrethit të tyre në rrethet Pukë, Tropojë, Kukës, Has, Malësi e Madhe, Dibër, Bulqizë deri në 4700 (katër mijë e shtatëqind) lekë kur punojnë në qytet dhe në qendër të rrethit dhe deri në 5800 (pesë mijë e tetëqind) lekë kur punojnë jashtë qytetit dhe qendrës së rrethit.

- Kur punojnë jashtë rrethit të tyre të vendbanimit në rrethet Mat, Mirditë, Gramsh, Librazhd, deri në 3500 (tre mijë e pesëqind) lekë kur punojnë në qytet dhe në qendër, dhe deri 4700 (katër mijë e shtatëqind) lekë kur punojnë jashtë qytetit dhe qendrës së rrethit.

- Kur punojnë jashtë rrethit të tyre të vendbanimit në rrethet e tjera deri në 2 400 (dymijë e katërqind) lekë kur punojnë në qytet dhe në qendrën e rrethit dhe deri 3500 (tremijë e pesëqind) lekë kur punojnë jashtë qytetit dhe qendrës së rrethit.